



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 819 Prot.

Tiranë, më 07.06 2019

VENDIM Nr. 138, datë 28.05.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, *Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 28.05.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit *"Restaurim tipologjik i godinës ekzistuese Banesë+shërbime dhe ndryshim destinacioni nga banesë në shërbime", pranë Amfiteatrit Romak, rruga "Kalaja", në zonën arkeologjike "A" Durrës*, subjekti Znj. Orjeta Tonuzi,

VENDOSI:

1. Të miratojë zhvillimin e projektit *"Restaurim tipologjik i godinës ekzistuese Banesë+shërbime dhe ndryshim destinacioni nga banesë në shërbime", pranë Amfiteatrit Romak, rruga "Kalaja", në zonën arkeologjike "A" Durrës*, subjekti Znj. Orjeta Tonuzi, me kushtin e ruajtjes së themeleve ekzistuese dhe moscënimit të territorit.
2. Subjekti Znj. Orjeta Tonuzi, të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, subjekti Znj. Orjeta Tonuzi, duhet të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik për fillimin e punimeve. Këto punime sipas fazave të zbatimit të projektit do të monitorohen nga DRKK Durrës, e cila duhet të depozitojë pranë ASHA informacionin në lidhje me to.
4. Në rast të domosdoshmërisë së kryerjes së punimeve të infrastrukturës inxhinjrike, të paparashikuara për projektin e sipërpërmendur, subjekti Znj. Orjeta Tonuzi, duhet të njoftojë zyrtarisht DRKK Durrës dhe ASHA. Ky subjekt duhet të lidhë paraprakisht, akt-marrëveshje tre palëshe me DRKK Durrës, e cila do të monitorojë në mënyrë periodike ditore kryerjen e këtyre punimeve, si dhe ASHA që do të realizojë mbikëqyrjen e tyre.
5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**